REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit**
**Nr.07/351/01-19817**
**Dt.13.11.2017**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Sh.P.K."Ylli Pashtriku", me seli në Gjakovë e regjistruar me numër të biznesit 70323544,** për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhesë, me etazhitet B+P+7, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97, bien këtë:

# A K T V E N D I M

**I. I LEJOHET: Investitorit Sh.P.K."Ylli Pashtriku", me seli në Gjakovë, e regjistruar me numër të biznesit 70323544,** ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë me destinim, objekt banimor - shumë banesor, Sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues – Kompleksi Urban "Gjakova 2005", Potezi përgjatë rrugës "Nena Tereze" - Gjakovë, në ngastrën kadastrale ndërtimore me numër 5797/0, ZK: Gjakovë – Qytet, në pronësi (QIRAMBAJTJE për 99 vite), të "Ylli Pashtriku" SHPK, në rrugën "Nëna Tereze", e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është B+P+7, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit **S= 4000.51 m²**

| | | |
|---|---|---|
| **Bodrumi:** | **(Sip.Bruto): .....** | **S=482.48 m²** |
| **Përdhesa:** | **(Sip,Bruto): .....** | **S=435.58 m²** |
| **Kati i parë:** | **(Sip,Bruto): .....** | **S=440.35 m²** |
| **Kati i dytë:** | **(Sip,Bruto): .....** | **S=440.35 m²** |
| **Kati i tretë:** | **(Sip,Bruto): .....** | **S=440.35 m²** |
| **Kati i katër:** | **(Sip,Bruto): .....** | **S=440.35 m²** |
| **Kati i pestë:** | **(Sip,Bruto): .....** | **S=440.35 m²** |
| **Kati i gjashtë:** | **(Sip,Bruto): .....** | **S=440.35 m²** |
| **Kati i shtatë:** | **(Sip,Bruto): .....** | **S=440.35 m²** |

**II.** Hartimin e projektit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese ndërtimore "D-PROJECT"-Prizren.

**III.** Pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi është lokacioni i objektit i prezantuar grafikisht në Plan Situacion me të gjithë parametrat, i cili është i miratuar nga kjo drejtori, i njëjti është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

**IV.** Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspekcionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

**V.** Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

# A r s y e t i m

**Sh.P.K. "Ylli Pashtriku", me seli në Gjakovë, e regjistruar me numër të biznesit 70323544,** ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-19817, dt. 12.09.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me etazhitet të objektit B+P+7, në ngastrën kadastrale ndërtimore me numër 5797/0, ZK: Gjakovë – Qytet, në rrugën "Nëna Tereze", siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:1000, të datës 14.08.2011, të vërtetar nga DUMM-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 07.09.2017, në pronësi (QIRAMBAJTJE për 99 vite) të "Ylli Pashtriku"SHPK - Gjakovë, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me numër të lëndës 4209/17, të datës 21.08.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Lejen Mjedisore Komunale me nr. 07-351/01 - 20105, dt.10.11.2017, lëshuar nga DUMM.
5. Vendimin me nr.94/2017, idt.17.10.2017, mbi aprovimin e rekomandimit të Komisionit të veçantë profesional të IKMM-së, për dhënien e pëlqimit për leje ndërtimi "Ylli Pashtriku" Gjakovë, nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, Ministra e Kulturës, Rinisë dhe Sportit –RKS.
6. Raporti mbi kërkimet gjeomekanike në teren si dhe kërkimet laboratorike në lokacionin e parashikuar për ndërtimin e objektit shumë banesor, në ngastrën kadastrale me nr. 5797/0, me investitor :Ylli Pashtriku "SHPK, të hartuar nga "Geomerkur" Sh.p.k.Gjakovë, gusht 2017..
7. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.192/17 me datë 12.09.2017, lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit emergjent, Departamenti i Parandalimit, Ministria e Punëve të Brendshme, Republika e Kosovës.
8. Certifikatën e Regjistrimit të biznesit, nga MTKI-RKS.
9. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, numër 430-B-358 të datës 13.11.2017.
10. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, me nr.1454, të datës 18.08.2017.
11. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.-Gjakovë, me nr.2414, të dt 18.08.2017.
12. Pëlqimin nga PTK- Sh.A.nr.41,Gjakovë, të datës 16.08.2017.
13. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Bankën për Biznes filiali në Gjakovë, të datës 10.11.2017.
14. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar ndërmarrja projektuese ndërtimore "D-PROJECT"-Prizren.

**Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 17023.82 Euro.**

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

**Aktvendimi i dorëzohet:**
- **Investitorit,**
- **Drejtorisë së Inspekcionit,**
- **Arkivit.**

**Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike**

**Zenel Shabani, jur. i dipl.**

**U. D. D r e j t o r i**

**Elida Bejtullahu, inxh. e dipl.e ark.**

# PLAN SITUACIONI

K.K. GJAKOVË

Zon. kadastrale : Gj.Qytet

parc.nr.5797-0




23. Dershor 2017 v.
Takeometri pregize
Auto CAD 2004

**P = 1 : 1 000**

Punoi :N.Sh."Geogauss" Gjakovë
DREJTORI
Xhelil Ferlini gjeom.

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GJAKOVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Gjakovë-qytet

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m2 |
|---|---|---|
| P-70705029-05797-0 | Pracelë / Parcela / Parcel | 8811,0 |
| | | |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1156

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 07.09.2017

Koha/ Vreme/ Time: 10:35:33

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: MCO GJAKOVË director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture: